



British Embassy  
Tirana



# INTEGRITETI I ZYRTARËVE TË ZGJEDHUR, PARTITË POLITIKE, DEKRIMINALIZIMI DHE SPAK

Raport monitorues për qarqet Shkodër-Dibër-Kukës

Tetor 2023 - Janar 2024

TIRANË



Ky raport realizohet në kuadër të projektit “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike” të mbështetur nga Ambasada Britanike në Tiranë. Projekti zbatohet në një koncorsium i drejtuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) në partneritet me Institutin e Studimeve Politike (ISP), BIRN Albania dhe Qëndresa Qytetare (QQ).

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të financuesve të tij apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

@Instituti i Studimeve Politike (ISP)

INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE

Web: [www.isp.com.al](http://www.isp.com.al)

E-mail: [contactaips@isp.com.al](mailto:contactaips@isp.com.al)

Facebook: Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies

Adresa: Rr “Luigj Gurakuqi”, Shk. A, P.89 K.3, Ap. 16, Tiranë

## TABELA E PËRMBAJTJES

ABSTRAKT .....	3
EXECUTIVE SUMMARY .....	4
CONCLUSIONS .....	5
GJETJET KRYESORE .....	6
HYRJE.....	7
I. DEKRIMINALIZIMI GJATË VITIT 2023 .....	9
II. VEPRIMTARIA E SPAK NDAJ ZYRTARËVE TË LARTË (JANAR-TETOR 2023) .....	11
III. DEKRIMINALIZIMI DHE SPAK NË QARKUN SHKODËR (TETOR 2023 – JANAR 2024).....	13
IV. DEKRIMINALIZIMI DHE SPAK NË QARKUN KUKËS (TETOR 2023 – JANAR 2024) .....	15
V. DEKRIMINALIZIMI DHE SPAK NË QARKUN DIBËR (TETOR 2023 – JANAR 2024) .....	17
PËRFUNDIME .....	18
REFERENCAT .....	20

## ABSTRAKT

Instituti i Studimeve Politike (ISP) në bashkëpunim me një grup organizatash të shoqërisë civile (Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Qëndresa Qytetare dhe BIRN Albania) po zbaton projektin “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike” i mbështetur nga Ambasada Britanike në Tiranë. Pjesë e projektit është monitorimi dhe raportimi i ecurisë së procesit të dekriminalizimit dhe jetësimit i standardeve të integritetit nga partitë politike. Të dhënat janë mbledhur nga stafi monitorues i ISP dhe janë kryqëzuar me të dhënat e grumbulluara nga komunikimi zyrtar me institucionet, nga raportimet në media dhe nga raportimet e institucioneve ligjzbatuese në Shqipëri.

Në pjesën e parë të këtij raporti, paraqitet në mënyrë të përmbledhur procesi i jetësimit të parimeve të dekriminalizimit nga partitë politike dhe institucionet kushtetuese në nivel kombëtar, si dhe lufta kundër korrupsionit në nivele të larta nga organet ligjzbatuese, me një fokus të veçantë tek puna e SPAK. Në vijim, nga niveli makro, në seksionin e dytë, raporti përqendrohet në monitorimin dhe analizimin e transparencës dhe llogaridhënien në zbatimin e standardeve të dekriminalizimit dhe integritetit për kandidatët, subjektet zgjedhore dhe institucionet vendore në qarkun e Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës.

## EXECUTIVE SUMMARY

- Decriminalization has reduced the presence of criminals in public administration and independent institutions. There were fewer candidates with criminal records in the last local elections on May 14, 2023. However, political parties continue to promote people with criminal backgrounds to public office. Nine mayors and 84 city council members were elected in the most recent local elections, all with criminal records.
- Between September 2023 and January 2024, 15 city council members from Shkoder, Kukes, and Diber resigned. One-third belong to the PSD, three in Diber and two in Puke, raising concerns about their integrity. This indicates that Albania still faces challenges in fully implementing the decriminalization law.
- Newly established judiciary institutions have improved their track record of combating corruption at the highest levels. For the first time in two decades, high-profile politicians have been indicted by SPAK, with some being arrested and others convicted by the Special Court against Corruption and Organized Crime. Former PM Berisha is under house arrest while former deputy PM Ahmentaj is hiding from the police, and former ministers and MPs have been convicted of power abuse or are under investigation by SPAK.
- In Kukes, SPAK arrested former mayor Safet Gjici for his involvement in a sexual scandal in his office. The Special Court recently convicted Mr. Gjici of abuse of power. Granit Gjana, the former mayor of Kukes, is being investigated by SPAK for procurement misconduct. He has been dismissed from his position and is facing legal action.
- Xhevahir Lita, the director of prosecution for Kukes, was dismissed by KPL after being arrested for alleged links to organized crime. Ardian Hajdari, a former member of the Appeals College at the vetting bodies, was sentenced to two years in prison for hidden income. Arben Smaci, Shkoder's prosecutor, has also been dismissed by the Appeals College for hidden income and untrue income declarations.
- Despite limited resources and political pressure, SPAK is breaking the cycle of impunity in Albania, facilitating the implementation of decriminalization law. The challenge of ending impunity persists, but progress is visible. However, the intention to pass a penal amnesty in the Assembly risks undermining the progress made thus far in the fight against high-level corruption.

## CONCLUSIONS

- Albania has made progress toward comprehensively implementing the decriminalization law. The growing pressure of public opinion and the international community has compelled political parties to implement codes of ethics and bar people with criminal records from their ranks and public office. The last local elections, held on May 14, 2023, provided fewer candidates and elected officials with criminal or corrupt backgrounds. Only five candidates for mayor and dozens of elected city council members were found to have had criminal records. This is a positive step toward breaking the links between politics and organised crime, thereby strengthening the rule of law and democratic progress in Albania.
- However, the informal influence of people with criminal or corrupt backgrounds in politics and business continues to be an issue of concern. In some municipalities (such as Durrës), powerful former officials with a problematic past supported the Socialist Party's mayoral candidate in the most recent local election. People with criminal backgrounds are still encouraged to run for office. Non-parliamentary parties appear to have provided shelter to those seeking political protection in recent years. While major parties under public pressure have implemented regulations to prevent the promotion of people with criminal records to public office, non-parliamentary parties have allowed candidates with criminal backgrounds to run for office.
- The decriminalization law has been widely implemented in Shkodër, Kukës, and Dibër, ensuring people without criminal records are allowed to carry out public functions. However, there have been cases in Mat, Shkodër, and Kukës where individuals with criminal records have been offered positions of power. Parliamentary parties have been careful to nominate candidates with no criminal records for office. However, smaller parties nominated candidates with criminal backgrounds, demonstrating that decriminalization law bends to crime on the outer edges of the country and politics.
- In the fight against corruption, the fully operational new judicial institutions have made advances in prosecuting high-ranking officials, including a former Prime Minister. SPAK has indicted former ministers, MPs, and public officials for alleged corruption, indicating that the culture of impunity faces a severe threat.
- SPAK took action in Shkoder and Kukes, where a former mayor, deputy mayor, two prosecutors, one judge, and a police officer were brought before the justice system. Middle and lower-level officials have also been indicted for alleged corruption and power abuse. This demonstrates that justice reform is paying off. However, assistance in strengthening its ability to combat corruption should continue to ensure that the new judiciary is effective and robust.

## GJETJET KRYESORE

- Procesi i dekriminalizimit ka vijuar të shënojë progres në aplikimin në institucionet përfaqësuese dhe kushtetuese si dhe me administratën publike. Në zgjedhjet e fundit vendore të 14 majit pati më pak kandidatë me të shkuar kriminale. Pavarësisht kësaj, partitë politike vijojnë të promovojnë individë me rekorde kriminale në funksionet publike. Nga zgjedhjet lokale të 14 majit 2023 rezulton se 9 kryetarë bashkie dhe 84 anëtarë të këshillave bashkiakë kanë probleme ligjore.
- Ndërkohë, gjatë periudhës shator 2023-janar 2024, 15 këshilltarë bashkiakë në bashkitë e në qarqet Shkodër, Kukës dhe Dibër kanë dhënë dorëheqje. Nga këta, 1/3 janë këshilltarë të PSD, 3 në Dibër dhe 2 në Pukë duke ngritur dyshime për pastërtinë e figurës dhe integritetit në përfaqësim. Kjo dëshmon se jetësimi në mënyrë integrale i parimeve të dekriminalizimit vijon të jetë sfidë për Shqipërinë.
- Veprimtaria e organeve të reja të drejtësisë kundër korrupsionit në nivele të larta është intensifikuar. Për herë të parë gjatë dy dekadave të fundit individë me peshë politike të madhe në jetën e vendit janë proceduar nga SPAK, disa janë në masë arresti, ndërsa të tjerë janë dënuar nga Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin. Ish-kryeministri Sali Berisha është vendosur nën arrest shtëpie, ish-zëvendëskryeministri Arben Ahmetaj është në kërkim ndërkombëtar i akuzuar për korrupsion, ndërsa ish-ministra dhe deputetë janë dënuar ose vijojnë të jenë nën hetim nga SPAK.
- SPAK ka vepruar në Kukës, duke arrestuar ish-kryebashkiakun Safet Gjici pas publikimit të një video skandali seksual. Së fundi, Gjykata e Posaçme e dënoi me burg z. Gjici për shpërdorim detyre. Ndërkohë, edhe ish-nënkryetari i bashkisë Kukës, Granit Gjana, është nën hetim nga SPAK për shkelje të barazisë në tendera. Ai është pezulluar nga detyra e Prefektit të Kukësit dhe po përballet me drejtësinë.
- Kryeprokurori i Kukësit, Xhevahir Lita është pezulluar nga detyra nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) pasi u arrestua nga SPAK si i dyshuar për lidhje korruptive me krimin e organizuar. Ish-anëtari i Kolegjit të Posaçëm të Apelit Ardian Hajdari është dënuar me dy vite shërbim prove për fshehje pasurie. Ndërsa, prokurori i Shkodrës Arben Smaçi u shkarkua nga Kolegji i Posaçëm i Apelit për deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme të pasurisë.
- Megjithë kapacitetet e limituara njerëzore dhe presionet politike, SPAK po tenton të çrrënjosë kulturën e pandëshkueshmërisë në vend, duke komplimentuar kështu më shumë implementimin e parimeve të dekriminalizimit. Sfida kundër kulturës së pandëshkueshmërisë mbetet, por progresi është evident. Tentativa për të votuar një amnisti penale në Kuvend rrezikon që të cenojë progresin e bërë në luftën kundër korrupsionit në nivele të larta.<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Shiko "Amnistia penale: Shqetësimi mbi përfitimin e politikanëve dhe zyrtarëve objekt të SPAK", ISP, 26 shkurt 2024.  
<https://dekriminalizimi.isp.com.al/amnistia-penale-shqetesimi-mbi-perfitimin-e-politikanëve-dhe-zyrtarëve-objekt-te-spak/>

## HYRJE

Tranzicioni politik i Shqipërisë nga një sistem i mbyllur totalitar drejt demokracisë funksionale është shënjuar nga pengesa të shumta, si mungesa e një tradite dhe kulture politike demokratike, trashëgimia komuniste në institucionet publike, partitë politike, median dhe në botën akademike. Deformimet e zgjedhjeve parlamentare dhe ato brenda partive politike, centralizimi i pushtetit në pak duar dhe ndërtimi i një sistemi ekonomik informal, kapja e drejtësisë dhe nënshtrimi i institucioneve të pavarura kushtetuese, deformimet dhe ndryshimet e njëpasnjëshme të Kodit Zgjedhor ndikuan në ndërtimin e një sistemi politik të mbyllur dhe jo llogaridhënës.

Ky zhvillim solli për rrjedhim deformimin e sistemit përfaqësues, minim të karrierës politike dhe publike në shërbimin civil në bazë të meritës profesionale dhe integritetit personal. Në rrethana të tilla, përfshirja e personave me rekorde kriminale dhe korruptive në radhët e para të politikës dhe jetës publike në administratë dhe institucionet e pavarura kushtetuese u bë dukuri normale. Kuvendi, institucioni më i lartë përfaqësues në Shqipëri, partitë politike dhe institucione të tjera publike u hapën rrugë individëve me të shkuar kriminale dhe korruptive, duke minuar edhe parimet e përfaqësimit, integritetit dhe demokracisë funksionale në vend.

Në këtë kuadër, me nismën e opozitës politike dhe mbështetjen e faktorit ndërkombëtar në Tiranë, Shqipëria ndërmori një hap radikal për pastrimin e politikës dhe institucioneve të vendit nga personat me rekorde kriminale dhe korruptive. Në vitin 2015, nën këtë trysni Kuvendi miratoi ligjin 138/2015 “*për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*”, i njohur ndryshe si ligji i dekriminalizimit. Subjekt i ligjit janë të gjithë funksionarët që zgjidhen apo emërohen në poste publike, duke detyruar kështu Kuvendin, Këshillin e Ministrave, institucionet kushtetuese dhe vendore, si dhe vetë partitë politike, të miratojnë kode etike dhe integriteti, me qëllim, jetësimin e standardeve të dekriminalizimit dhe evitimin e emërimeve apo zgjedhjeve që mund të sjellin shkelje të ligjit dhe skandale politike.

Siç ka konstatuar ISP në monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të ligjit të dekriminalizimit dhe në raportet periodike, Shqipëria ka bërë progres të ngadaltë në ndarjen e politikës dhe shtetit nga individët me rekorde kriminale.<sup>2</sup> Promovimi i personave me të shkuar kriminale dhe probleme me korrupsionin në institucionet qendrore si Kuvendi, degët e qeverisë, sistemin e drejtësisë pas reformës radikale të vlerësimit të pastërtisë së figurës së gjyqtarëve dhe prokurorëve është dekurajuar. Megjithatë, mungesa e mekanizmave të brendshëm funksionalë për parandalimin e individëve me të shkuar kriminale, transparencja dhe llogaridhënia e ulët nga partitë politike dhe institucionet qendrore e vendore, mungesa e kapaciteteve institucionale të institucioneve të

<sup>2</sup> Shiko ISP. (2023). Dekriminalizimi dhe integriteti: Raport me gjetje dhe rekomandime 2021-2023.

<https://dekriminalizimi.isp.com.al/dekriminalizimi-dhe-integriteti-raport-me-gjetje-dhe-rekomandime-2021-2023/>; ISP. (2022). Integriteti i zyrtarëve të lartë dhe standardet e dekriminalizimit. <https://dekriminalizimi.isp.com.al/integriteti-i-zyrtareve-te-larte-dhe-standardet-e-dekriminalizimit-2022/>; ISP. (2023). Mbi standardet e integritetit dhe dekriminalizimit në 12 qarqe (II) <https://dekriminalizimi.isp.com.al/isp-mbi-standardet-e-integritetit-dhe-dekriminalizimit-ne-12-qarqe-ii/>



drejtësisë për verifikime të shpejta paraprake mbeten sfida në implementimin gjithëpërfshirës të parimeve të dekriminalizimit.<sup>3</sup>

Si pasojë e ligjit të dekriminalizimit, presionit të faktorit ndërkombëtar dhe opinionit publik për politikë dhe administratë publike të pastër dhe me integritet, format e influencës së individëve të botës së kimit kanë ndryshuar natyrë dhe është sofistikuar.<sup>4</sup> Lidhjet e politikës me botën e kimit janë bërë më informale, nëpërmjet mbështetjes së figurave të treta pa probleme me ligjin (kryesisht në Bashkinë Durrës, në Shkodër etj.) të komandueshëm në postet publike dhe financimit të fushatave elektorale të partive politike. Gjithashtu, në nivelet e ulëta të qeverisjes vendore dhe administratës publike ku vëmendja e opinionit publik, medias dhe organizatave të shoqërisë civile është më e ulët, promovimi i individëve me probleme me ligjin ka vijuar të mbetet problem pavarësisht progresit të evidentuar.

Faza në të cilën ka hyrë Shqipëria në procesin e integritit evropian kërkon që jetësimi gjithëpërfshirës dhe integral i parimeve të dekriminalizimit të intensifikohet. Fillimi i bisedimeve për anëtarësim me BE, është një hap historik për Shqipërinë, por mbart sfida të rëndësishme në drejtim të forcimit të shtetit të së drejtës, pavarësisht dhe forcimit të institucioneve demokratike, si dhe një politikë dhe administratë publike profesionale dhe të pastër.

Ndërkohë, progresi në këtë drejtim është i lidhur ngushtë më luftën kundër korrupsionit dhe kimit të organizuar, të cilët gërryejnë cilësinë e përfaqësimit politik, qeverisjen e mirë, drejtësinë dhe demokracinë funksionale. Në progres-raportin e fundit të Komisionit Evropian theksohet se pavarësisht avancimit në luftën kundër korrupsionit, në tërësi *korupsioni është i përhapur në të gjitha fushat e jetës publike dhe ekonomike dhe se masat kundër tij vijojnë të kenë ndikim të vogël veçanërisht në sektorë vulnerabël*.<sup>5</sup> Edhe në raportin e fundit të Transparency International, indeksi i perceptimit të korrupsionit në Shqipëri mbetet i lartë, duke shënuar një progres të lehtë prej një pike krahasuar me vitin 2022, kryesisht për shkak të veprimit efektiv të SPAK në nivelet e larta të shtetit.<sup>6</sup>

Miratimi i reformës në drejtësi dhe ndërtimi një kornize institucionale të fortë kundër korrupsionit dhe kimit të organizuar ka filluar të japë efektet e para pozitive. Gjatë kohës së shkrimit të këtij raporti një numër i lartë zyrtarësh janë arrestuar nga SPAK, disa janë nën hetim, ndërsa një pjesë janë dënuar nga GjKKO. Midis tyre bëjnë pjesë dy politikanë shumë të lartë, ish kryeministri Sali Berisha, ish zv/kryeministri Arben Ahmetaj (2021-1922), etj. Ky i fundit ende në kërkim

<sup>3</sup> ISP. (2022). Institucionet, mbi 90% e tyre nuk i publikojnë formularët e dekriminalizimit. <https://dekriminalizimi.isp.com.al/institucionet-mbi-90-e-tyre-nuk-i-publikojne-formulare-t-e-dekriminalizimit/>; Shiko gjithashtu ISP. (2021). Dekriminalizimi dhe integriteti i zyrtarëve të zgjedhur: zgjedhjet 2021. <https://dekriminalizimi.isp.com.al/raport-i-isp-dekriminalizimi-dhe-integriteti-i-zyrtareve-te-zgjedhur-zgjedhjet-2021/>; Shiko Ola Mitre, “Suksesi i pjesshëm i dekriminalizimit në luftën për pastrimin e politikës”, Reporter.al, 30 shkurt 2020. <https://www.reporter.al/2020/02/03/suksesi-i-pjesshem-i-dekriminalizimit-ne-luften-per-pastrimin-e-politikes/>

<sup>4</sup> ISP. (2023). Dekriminalizimi dhe integriteti: Raport me gjetje dhe rekomandime 2021-2023. <https://dekriminalizimi.isp.com.al/dekriminalizimi-dhe-integriteti-raport-me-gjetje-dhe-rekomandime-2021-2023/>

<sup>5</sup> EU Commission progress report on Albania, 2023. Final: Brussels. [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda\\_23\\_5612](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda_23_5612)

<sup>6</sup> Transparency International Perception Index, Albania 2023. <https://www.transparency.org/en/countries/albania>

ndërkombëtar i akuzuar për korrupsion. Ish-zv/kryeministri e humbi mandatin vetëm pas skadimit të periudhës 6 mujore të mungesës në parlament, ndërkohë që drejtësia e re ka dhënë dënime për zyrtarë të tjerë të lartë si: ish-ministrin e Mjedisit Lefter Koka, ish-deputetin Alqi Bllako, si dhe për zyrtarë të tjerë. Një numër i madh zyrtarësh të tjerë të nivelit të lartë, përfshirë katër ish-kryebashkiakë (Bulqizë, Durrës, Lushnjë dhe Kukës, ky i fundit i zgjedhur edhe në zgjedhjet e fundit vendore në maj 2023), janë në proces gjykimi ose të dënuar për abuzim me detyrën dhe korrupsion.

Megjithatë, zgjedhjet e fundit vendore të majit 2023, ku sipas deklarimeve të KQZ 10 kandidatë për kryetar bashkie dhe 28 kandidatë për anëtar të këshillit bashkiak u dërguan për hetim të thelluar në Prokurori, tregojnë se partitë politike dhe Shqipëria në tërësi kanë akoma rrugë për të bërë në promovimin, emërimin dhe zgjedhjen e kandidatëve të pastër dhe me integritet në funksionet publike. Jo të gjitha subjektet e dërguara për verifikim të thelluar ishin ose rezultuan individë me rekorde kriminale, por dyshimet e arsyeshme detyruan KQZ të referonte në Prokurori një pjesë të tyre, përfshirë edhe kryetarë bashkie. Individë me rekorde kriminale vijojnë të ushtrojnë ndikim në mënyrë informale në jetën politike dhe publike të vendit. Institucionet kanë treguar se në përgjithësi janë të prirura të bëjnë ndryshime në kornizën ligjore, por niveli i zbatimit në praktikë të ligjeve vijon të jetë problematik dhe sfidë për proceset demokratizuese dhe integruese të Shqipërisë.

## I. DEKRIMINALIZIMI GJATË VITIT 2023

Viti 2023 ka qenë një periudhë e ngarkuar me zhvillime politike në Shqipëri ku u mbajtën zgjedhjet e rregullta vendore në 14 maj si dhe u përsëritën zgjedhjet për kryetarin e bashkisë në Rrogozhinë. Gjithashtu u zhvilluan zgjedhje të pjesshme për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë në Kukës pas dorëheqjes së kryebashkiakut të sapo zgjedhur Safet Gjici, i cili u përfshi në një skandal seksual në zyrën e tij. Mbajtja e zgjedhjeve paraprihet nga nominimet e kandidatëve për kryetar bashkie dhe këshillat bashkiakë nga subjektet zgjedhore. Në këtë kuptim, zgjedhjet janë një test i rëndësishëm për implementimin e standardeve të dekriminalizimit nga partitë politike së pari si subjekte zgjedhore përgjegjëse për të garantuar kandidatë me integritet, si dhe nga institucionet përgjegjëse për ushtrimin e kontrollit të pastërtisë së figurës së kandidatëve, si KQZ dhe Prokuroria e Përgjithshme.

KQZ është organi përgjegjës për verifikimin dhe zbatimin e ndalimeve, për zgjedhjen dhe emërimin në funksione publike, për të zgjedhurit dhe kandidatët për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë apo në organet e qeverisjes vendore, si edhe për anëtarët e Këshillit të Ministrave, që nuk kanë mandat deputeti dhe nuk kanë paraqitur paraprakisht vetëdeklarim.<sup>7</sup> Ndërsa Prokuroria bën hetime të

<sup>7</sup> Sipas ligjit nr.138/2015 dhe Vendimit të Kuvendit nr.17/2016 dhe Vendimit i Kuvendit nr.17/2016

thelluara kur i referohen rastet nga KQZ. Megjithatë, procesi i ngadaltë i hetimit të thelluar nga Prokuroria si pasojë e vonesës në shkëmbimin e informacionit me organet ligjzbatuese të huaja, ka bërë që efekti parandalues i ligjit të dekriminalizimit të jetë minimal.

Megjithëse duket se ka pasur progres në zbatimin e parimeve të dekriminalizimit nga subjektet zgjedhore, përsëri vihet re tendenca për të kandiduar individë me rekorde të dyshimta kriminale dhe rrjedhimisht pa integritet personal për të ushtruar detyra publike. Përpara zgjedhjeve të fundit vendore të 14 majit 2023, KQZ në bazë formularëve të dekriminalizimit referoi tek Prokuroria për hetime të thelluara 10 kandidatë për kryetar bashkie dhe 28 kandidatë për këshillat bashkiak.<sup>8</sup>

Pesë kandidatë të zgjedhur kryetarë bashkie janë dërguar paraprakisht nga KQZ për hetim të thelluar.

1. **Kristian Shkreli**, kryetar i bashkisë Vau i Dejës (Partia Socialiste), ka deklaruar në formularin e dekriminalizimit<sup>9</sup> se në datë 10.04.2007 është dëbuar nga Italia si emigrant pa dokumenta.
2. **Dhionisios Alfred Petro Beleri**, kryebashkiak i zgjedhur për bashkinë Himarë (Bashkë Fitojmë), ka deklaruar në formularin e dekriminalizimit<sup>10</sup> se është dënuar nga Gjykata e Apelit Athinë me 18 muaj burgim për armëmbajtje pa leje; dënuar nga Gjykata e Apelit Vlorë me 3 vjet burgim për thirrje për urrejtje nacionale, poshtërim i Republikës dhe simboleve të saj; është ndaluar nga Prokuroria Athinë dhe Janinë për hetime; është ndaluar nga policia kufitare aeroporti Athinë për verifikim dokumentacioni.
3. **Qerim Ismailaj**, kryetar i bashkisë Mallakastër (Partia Socialiste), ka deklaruar në formularin e dekriminalizimit<sup>11</sup> se është dënuar në Greqi-3 vite për konflikt, përleshje; gjithashtu është dënuar në Shqipëri nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me 6 muaj burg.
4. **Kreshnik Hajdari**,<sup>12</sup> kryetar i bashkisë Kuçovë (Partia Socialiste) nuk ka deklaruar rekorde kriminale në formularin e dekriminalizimit, edhe pse referuar listës së publikuar nga KQZ, të dhënat e tij janë dërguar për hetim të thelluar.
5. **Artur Bushi**, kryetar i bashkisë Krujë (Partia Socialiste), referuar listës së publikuar nga KQZ, të dhënat e tij janë dërguar për hetim të thelluar, por në faqen zyrtare të KQZ nuk është publikuar formulari i dekriminalizimit.

Asnjë nga këta emra nuk u ndalua të kandidonte në zgjedhjet vendore të 14 majit pasi KQZ vlerësoi se nuk ishin në mospërputhje me parimet e ligjit të dekriminalizimit. Megjithatë koha

<sup>8</sup> “Zgjedhjet e 14 majit, KQZ çon për verifikim të thelluar 10 kandidatë për kryetar bashkie dhe 28 për anëtarë këshilli”, Top Channel, 9 maj 2023. <https://top-channel.tv/2023/05/09/zgjedhjet-e-14-majit-kqz-con-per-verifikim-te-thelluar-10-kandidate-per-kryetar-bashkie-dhe-28-per-anetare-keshilli/>

<sup>9</sup> KQZ. Formulari i dekriminalizimit, subjekti Kristian Shkreli. [https://dekriminalizimi.kqz.gov.al/Vau-Dej%C3%ABs/PS/0\\_vau-\\_010052\\_kr\\_lu\\_sh\\_PS.pdf](https://dekriminalizimi.kqz.gov.al/Vau-Dej%C3%ABs/PS/0_vau-_010052_kr_lu_sh_PS.pdf)

<sup>10</sup> KQZ. Formulari i dekriminalizimit, subjekti Dhionisios Alfred Petro Beleri.

[https://dekriminalizimi.kqz.gov.al/Himar%C3%AB/BF/0\\_hima\\_013387\\_dh\\_pe\\_be\\_BF20230424\\_131746.pdf](https://dekriminalizimi.kqz.gov.al/Himar%C3%AB/BF/0_hima_013387_dh_pe_be_BF20230424_131746.pdf)

<sup>11</sup> KQZ. Formulari i dekriminalizimit, subjekti Qerim Ismailaj.

[https://dekriminalizimi.kqz.gov.al/Mallakast%C3%ABr/PS/0\\_mall\\_016657\\_qe\\_is\\_is\\_PS20230415\\_105838.pdf](https://dekriminalizimi.kqz.gov.al/Mallakast%C3%ABr/PS/0_mall_016657_qe_is_is_PS20230415_105838.pdf)

<sup>12</sup> KQZ. Formulari i dekriminalizimit, subjekti Kreshnik Hajdari

[https://dekriminalizimi.kqz.gov.al/Ku%C3%A7ov%C3%AB/PS/0\\_kuco\\_017366\\_kr\\_ri\\_ha\\_PS20230415\\_103101.pdf](https://dekriminalizimi.kqz.gov.al/Ku%C3%A7ov%C3%AB/PS/0_kuco_017366_kr_ri_ha_PS20230415_103101.pdf)

në dispozicion të Prokurorisë për hetime të thelluara mbetet shumë e shkurtër në mungesë të instrumenteve ligjore për të marrë përgjigje të shpejtë nga agjencitë ligj zbatuese partnere, çka tregon së duhet forcuar praktika e verifikimit paraprak nga partitë politike dhe institucionet ligj zbatuese. Për shembull, në rastin Shkreli vendimi i KQZ doli në fundin e shkurtit 2024, pra 10 muaj pas zgjedhjes kryetar.

Paralelisht 28 kandidatë për këshillat bashkiakë u dërguan paraprakisht nga KQZ për hetim të thelluar. Pas hetimit rezultoi se 21 kandidatë nuk janë zgjedhur fitues ose nuk janë lejuar të garojnë në zgjedhjet lokale. Shtatë anëtarë të zgjedhur të këshillave bashkiakë janë mandatuar pas hetimit nga prokuroria. Referuar formularëve të dekriminalizimit dhe verifikimeve të thelluara të kryera nga KQZ, në rang kombëtar kemi 9 kryetarë bashkie dhe 84 anëtarë të këshillave bashkiakë me rekorde të dyshuara kriminale. Në total janë 103 ose 6.4 % e formularëve të dekriminalizimit me probleme. Disa prej tyre paraqesin mangësi në deklaram, të dhëna të pasakta ose rekorde të fshehura.

Ish-kryetari i bashkisë Kukës është dënuar nga GJKO, kurse kryetari i zgjedhur i bashkisë Himarë vijon të jetë në paraburgim i dyshuar për një krim zgjedhor, arrestuar dy ditë para zgjedhjeve të majit 2023. Dy kryetarë të tjerë bashkie janë në hetime fundore nga SPAK dhe në rastin e Kuçovës SPAK konfirmoi fshehjen e deklarimeve të dënimit nga kryetari i bashkisë, përgjegjësi ligjore e pranuar edhe nga ai vetë.<sup>13</sup>

## II. VEPRIMTARIA E SPAK NDAJ ZYRTARËVE TË LARTË (JANAR-TETOR 2023)

Jetësimi i reformës në drejtësi, ngritja tërësisht funksionale e institucioneve të reja si SPAK, BKH dhe GJKKO, ka intensifikuar luftën kundër korrupsionit në nivele të larta si parakusht për avancimin e Shqipërisë në rrugën e procesit të integritimit evropian. Një numër i lartë zyrtarësh deri në nivel qeveritar janë proceduar nga SPAK duke shënuar kështu një hap të rëndësishëm në drejtim të çrrënjësjes së pandëshkueshmërisë në vend.

- Ish zv/kryeministri Arben Ahmetaj është proceduar nga SPAK për korrupsion, pastrim parash dhe fshehje pasurie.<sup>14</sup> Megjithëse Kuvendi dha miratimin për arrestimin e tij, ai rezultoi të ishte larguar nga vendi dhe vijon të jetë në kërkim ndërkombëtar.
- GJKKO në datë 25.09.2023 ka dënuar me 6 vite e 8 muaj burgim Lefter Kokën, ministër i mjedisit në vitet 2013-2017. Z. Koka ishte nën akuzë për veprat penale "shpërdorimi i

<sup>13</sup> "Fshehu dënimin nga drejtësia greke, SPAK nis hetimet për kryebashkiakun e Kuçovës, Kreshnik Hajdari", Ballkan Web, 26 qershor 2023. <https://www.balkanweb.com/fshehu-denimin-nga-drejtesia-greke-spak-nis-hetimet-per-kryebashkiakun-ekucoves-kreshnik-hajdari/#gsc.tab=0>

<sup>14</sup> "SPAK tre akuza ndaj Arben Ahmetajt, sa vite burg rrezikon ish-ministri", ABC News, 10 korrik 2023. <https://abcnews.al/spak-tre-akuza-ndaj-arben-ahmetajt-sa-vite-burg-rrezikon-ish-ministri/>

detyrës", "korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë" dhe "pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale". Ndërkohë z. Koka është nën hetim edhe për dyshime shpërdorim detyre në rastin e koncensionit të inceneratorit të Tiranës.<sup>15</sup>

- Alqi Bllako, ish-sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit të Shqipërisë dhe ish-deputet i Partisë Socialiste, është dënuar me 2 vite e 8 muaj burgim për veprën penale "shpërdorimi i detyrës". Në vendimin përfundimtar z. Bllako i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 5 pesë vjetësh. Z. Bllako është vendosur nën hetim përsëri nga SPAK i akuzuar për "korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë" në rastin e koncensionit të inceneratorit të Tiranës.<sup>16</sup>
- Ish-ministri i Shëndetësisë Ilir Beqja është proceduar nga SPAK për shpërdorim detyre në çështjen e sterilizimit të pajisjeve mjekësore. Ndaj tij tashmë është marrë masa e detyrimit të paraqitjes nga GJKKO, ndërkohë që BKH po e heton z. Beqja për shpërdorim të fondeve të huaja në kohën që ai mbante detyrën e drejtorit në Agjencinë e Koordinimit të Ndhmës së Huaj.<sup>17</sup>
- Ish-kryeministri Sali Berisha, një nga figurat politike që ka shënjuar tranzicionin politik të Shqipërisë, dy herë president dhe dy herë kryeministër është vendosur nën arrest shtëpie nga GJKKO pas kërkesës së SPAK, i cili e akuzon për korrupsion në çështjen e klubit "Partizani".<sup>18</sup>
- Ish-ministrja e Jashtme Olta Xhaçka është nën hetim nga SPAK, ndërkohë që parlamenti ende nuk ka një vendimmarrje finale lidhur me mandatin e saj parlamentar, pasi akuzohet për keqpërdorim të pozitës në qeveri dhe parlament, duke krijuar benefite për bashkëshortin e saj për të fituar statutin e investitorit strategjik. Kuvendi refuzoi procedurën, por Gjykata Kushtetuese detyroi Kuvendin të marrë një vendim, i cili është për në procedurë për në muajin nëntor 2023.
- Kryetari i zgjedhur i Bashkisë Himarë, Alfred Beleri vijon të jetë në arrest dhe SPAK ka kërkuar 2.6 vite burg me akuzën për blerje votash.<sup>19</sup>

Përpos kësaj, SPAK ka vijuar të japë rezultate konkrete edhe në hetimin e zyrtarëve të tjerë të lartë të zgjedhur. Gjatë periudhës shtator 2022 - tetor 2023 janë arrestuar me akuza të ndryshme 3 kryetarë bashkie, dy ish-kryetarë dhe një ish-nënkryetar, si vijon: Lefter Alla kryetar i Bashkisë Bulqizë; Safet Gjici kryetar i Bashkisë Kukës; Fran Tuci ish-kryetar i Bashkisë Fushë-Arrëz; Vangjush Dako ish-kryetar i Bashkisë Durrës dhe Andri Çota ish-nënkryetar i Bashkisë Librazhd.

<sup>15</sup> "Hetimi për inceneratorin e Tiranës, SPAK jep njoftimin zyrtar: 7 shkeljet dhe pse akuzohen", Shqiptarja.com, 9 dhjetor 2023. <https://shqiptarja.com/lajm/hetimi-per-inceneratorin-e-tiranes-spak-jep-njoftimin-zyrtar-6-shkeljet-dhe-pse-akuzohen>

<sup>16</sup> Po aty.

<sup>17</sup> Vladimir Karaj, "Hetim i ri në SPAK, kontrollohet shtëpia e ish-ministrit Ilir Beqaj", Reporter.al, 29 dhjetor 2023. <https://www.reporter.al/2023/12/29/hetim-i-ri-ne-spak-kontrollohet-shtepia-e-ish-ministrit-ilir-beqaj/>

<sup>18</sup> Albanian prosecutors charge former Prime Minister Sali Berisha in corruption probe, Reuter, 22 October 2023. <https://www.reuters.com/world/europe/albanian-prosecutors-charge-former-pm-berisha-corruption-probe-2023-10-22/>

<sup>19</sup> Edmond Hoxhaj, "SPAK kërkon 2.6 vjet burg për Fredi Belerin". Reporter.al, 13 shkurt 2023. <https://www.reporter.al/2024/02/13/spak-kerkon-2-6-vjet-burg-per-fredi-belerin/>

### III. DEKRIMINALIZIMI DHE SPAK NË QARKUN SHKODËR (TETOR 2023 – JANAR 2024)

Qarku Shkodër përbëhet nga pesë bashki, respektivisht, bashkia Shkodër, Malësi e Madhe, Vau-Dejës, Pukë dhe Fushë-Arrëz. Në këtë qark, pesë kryetarë bashkie dhe 97 anëtarë për këshillin bashkiak kanë dalë nga zgjedhjet vendore të 14 majit 2023. Në bashkinë Shkodër, Benet Beci, u zgjodh kryetar bashkie duke shënuar fitoren e parë në nivel vendor për Partinë Socialiste (PS) në këtë njësi vendore. Në Malësi të Madhe kryetar bashkie u zgjodh Tonin Marinaj (PS); në Vaun e Dejës Kristian Shkreli (PS), në Pukë Gjon Gjonaj (PS) dhe në Fushë-Arrëz u zgjodh Hil Curri (Bashkë Fitojmë). Marina Duhani u zgjodh kryetare e Këshillit të Qarkut pas një koalicioni të pashpallur mes PS dhe PSD, por së fundi ajo dha dorëheqjen pas mosmarrëveshjeve mes forcave politike qeverisëse në Shkodër.<sup>20</sup>

Në nivel qarku, një kryetar bashkie Kristian Shkreli (PS) dhe 4 anëtarë të këshillave bashkiakë rezultojnë të dyshuar me rekorde kriminale. Respektivisht, 2 në këshillin bashkiak Shkodër, 1 në Vaun e Dejës dhe 1 në Pukë. Për pesë të tjerë nuk ka të dhëna në sistem, çka ngre shqetësime për nivelin e transparencës dhe llogaridhënies.

Sa i përket përkatësisë politike, në këshillin bashkiak Shkodër, rezulton se koalicioni Bashkë Fitojmë dhe Partia Socialiste kanë promovuar nga një kandidat me rekorde kriminale E.D (BF) dhe U.GJ (PS), ndërsa PD ka një anëtar (GJ.M) me rekorde kriminale në këshillin bashkiak Vau-Dejës. Malësia e Madhe rezulton me këshillin bashkiak më të pastër, pa asnjë anëtar me rekord kriminal.



*Tabela 1\_Nr. i këshilltarëve me rekorde kriminale sipas partive- qarku Shkodër*

Por, gjatë periudhës post-zgjedhore në qarkun Shkodër kanë dhënë dorëheqjen 6 këshilltarë bashkiakë. Respektivisht, 1 në bashkinë Shkodër R.B (PS); 2 në Pukë D.GJ (PSD), D.S (Bashkë Fitojmë); 1 në Malësi të Madhe V.M (FRD); 1 në Fushë Arrëz N.M (PSD) dhe 1 në Vaun e Dejës

<sup>20</sup> "Përplasje mes PS dhe PSD? Ikën kryetarja e qarkut Shkodër, zëvendësohet nga një socialist. Çfarë thotë vetë". Java News, 29 janar 2024. <https://javanews.al/perplasje-mes-ps-dhe-psd-ikën-kryetarja-e-qarkut-Shkoder-zëvendësohet-nga-një-socialist-çfarë-thotë-vetë/>

S.N (PSD). Arsytet e dorëheqjeve nga mandati nuk bëhen të ditura në vendimet e dorëzimit të mandatit.<sup>21</sup>

Numri i ulët i këshilltarëve me rekorde kriminale, tregon se partitë politike ndihen nën presion nga publiku, media dhe faktori ndërkombëtar, kështu që kanë jetësuar në mënyrë më integrale parimet e dekriminalizimit. Megjithatë, nga monitorimi i ISP vihet re se partitë e mëdha politike, respektivisht PS, PD dhe fraksioni i drejtuar nga ish-kryeministri Berisha në koalicion me

PL e Ilir Meta, kanë tendencë për të vijuar promovimin në partitë e tyre politike të individëve me të shkuar problematike. Individët e fortë me rekorde kriminale po ushtrojnë influencë në forma të sofistikuar ndaj partive politike nëpërmjet financimit të fushatave dhe vendosjes përpara në lista kandidatësh të individëve nga familjet e tyre ose të deleguar prej tyre, por të pastër në letra.

Pas arrestimit të Fran Tucit, ish-kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz dhe z. N. M, ish-administratorit të Njësisë Administrative Iballë, nën akuzën për “shpërdorim detyre” kryer në bashkëpunim dhe “shkatërrimi i pronës”, SPAK ka vepruar edhe gjatë kësaj periudhe në luftën kundër korrupsionit. M.GJ, punonjës i Policisë Kufitare në Shkodër është arrestuar nga SPAK i dyshuar për përfshirje në korrupsion pasiv. Ndërkohë, ish-anëtari i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, Ardian Hajdari u dënua me dy vite shërbim prove pasi është shpallur fajtor për fshehje pasurie. Gjithashtu edhe prokurori i Shkodrës, Arben Smaçi u shkarkua nga Kolegji i Posaçëm i Apelit për deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme të pasurisë.

Prandaj, megjithë progresin e vërejtur në qarkun Shkodër, lind nevoja që partitë politike të institucionalizojnë praktika të mira dhe integrale në promovimin e individëve të pastër në funksionet publike dhe transparencë në financimin e fushatave zgjedhore. Kjo kërkon një qasje më gjithëpërfshirëse ndaj parimeve të dekriminalizimit dhe ndryshime të mundshme në kodin zgjedhor dhe ligjin për partitë politike. Ndërkohë, veprimtari e SPKA në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është një mekanizëm shtesë, që po ndihmon në procesin e dekriminalizimit në jetën politike dhe institucionet publike.

---

<sup>21</sup> Shiko p.sh rastin e Shkodrës. Vendimi i Këshillit Bashkiak për për mbarim para kohë të mandatit të këshilltarit, [https://bashkiashkoder.gov.al/vendime\\_te\\_keshillit/vendim-i-keshillit-bashkiak-nr-11-dt-20-07-2023/](https://bashkiashkoder.gov.al/vendime_te_keshillit/vendim-i-keshillit-bashkiak-nr-11-dt-20-07-2023/)

E njëjta praktikë vihet re në mënyrë uniforme në të gjithë keshillat bashkiakë të marrë në konsideratë në qarqet Shkodër, Kukës dhe Dibër.

## IV. DEKRIMINALIZIMI DHE SPAK NË QARKUN KUKËS (TETOR 2023 – JANAR 2024)

Qarku Kukës përbëhet nga tri bashki, Kukës, Has dhe Tropojë. Në këtë qark në zgjedhjet vendore të 14 majit 2023 u zgjodhën 3 kryetarë bashkie dhe 73 anëtarë për këshillin bashkiak. Në Kukës, Safet Gjici (PS) fitoi zgjedhjet e 14 majit, por u dorëhoq/shkarkua shpejt pas përfshirjes në një skandal seksual në zyrën e tij. Në Has, kryetar bashkie u zgjodh Miftar Dauti (Bashkë Fitojmë), ndërsa në Tropojë, Rexh Byberi (PS) fitoi zgjedhjet për kryetar bashkie. Nga monitorimi i ISP dhe deklaratimet në formularët e dekriminalizimit në KQZ, rezultojnë se 5 anëtarë të këshillave bashkiakë janë me të shkuar kriminale.

Safet Gjici (PS) mori mandatin e dytë për të drejtuar bashkinë e Kukësit në zgjedhjet e 14 majit. Por pas përfshirjes në një skandal seksual në zyrën e tij u arrestua nga SPAK me akuzën e shpërdorimit të detyrës.<sup>22</sup> Video skandali u shoqërua me dorëheqje dhe shkarkim të z. Gjici çka i hapi rrugë zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie në Kukës në datë 24 shtator 2023. Pas përfundimit të procesit, kryetari i ri i bashkisë u zgjodh Albert Halilaj, përfaqësues i Partisë Socialiste. Referuar formularit të dekriminalizimit të publikuar në faqen e KQZ, z. Halilaj rezultoi se nuk ka rekorde kriminale.<sup>23</sup>




Tabela 2\_Nr. i këshilltarëve me rekorde kriminale qarku Kukës

Nga monitorimi i ISP rezultoi se Bashkia Kukës ka numrin më të lartë të këshilltarëve të zgjedhur me rekorde kriminale. Ndërkohë, gjatë periudhës së marrë në studim, rezultoi se 8 anëtarë të këshillave bashkiakë kanë dhënë dorëheqje nga mandati. Në bashkinë Kukës 2 anëtarë të dorëhequr, V.D (PAA); B.P (Nisma Thurrje); në Tropojë një anëtar i Bashkë Fitojmë (D.GJ), dhe në Has 2 anëtarë, A.G (Bashkë Fitojmë) dhe SH.SH (LZHK). Edhe në qarkun e Kukës nuk bëhen të ditura arsyet e dorëheqjeve, duke ngritur dyshime për presione politike, dorëheqje

<sup>22</sup> Edmond Hoxhaj, "Pas publikimit të videos seksuale, Safet Gjici arrestohet për korrupsion". Reporter.al 25 qershor 2023. <https://www.reporter.al/2023/06/24/pas-publikimit-te-videos-seksuale-safet-gjici-arrestohet-per-korrupsion/>

<sup>23</sup> KQZ, Vendim për dhënie mandati. [https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/09/FVD\\_ALBERT\\_HALILAJ\\_PS\\_QARKU\\_KUKES.pdf](https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/09/FVD_ALBERT_HALILAJ_PS_QARKU_KUKES.pdf)



për shkak të problemeve me ligjin dekriminalizimit apo lojëra politike brenda dhe mes partive politike.

Ndryshe nga bashkitë e tjera, individët me të shkuar kriminale duket se në Kukës janë fshehur pas siglave të partive të vogla politike. Kjo është bërë një praktikë e njohur tashmë ku njerëz me probleme me ligjin gjejnë strehë tek forcat e vogla politike të cilat zakonisht nuk monitorohen aq sa duhet nga media sepse nuk tërheqin vëmendje. Partitë politike jo parlamentare nuk kanë krijuar praktika të mira të verifikimit paraprak të integritetit të kandidatëve apo institucionalizuar kode të cilat parandalojnë depërtimin e individëve me të shkuar kriminale në pozicione publike. Të udhëhequr nga interesa të ngushta elektorale, këto parti i hapin rrugë personave me të shkuar kriminale, veçanërisht në njësitë vendore periferike të Shqipërisë kur presioni publik dhe monitorimi është më i ulët.

Sa i përket veprimtarisë së institucioneve të drejtësisë në luftën kundër korrupsionit, bashkia Kukës u vendos në qendër të vëmendjes së opinionin politik dhe publik në vend pas arrestimit të Safet Gjicit, ish-kryetarit të bashkisë Kukës tashmë, një figurë politike me ndikim në zonë. Pas kërkesës së SPAK, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë vendosi të mërkurën, më 7 shkurt 2024, deklarin fajtor të ish-kryetarit të bashkisë së Kukësit, Safet Gjici për veprën penale “shpërdorimi i detyrës”, lidhur me aferën seksuale në zyrën e tij dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim, që në aplikim të gjykimit të shkurtuar u reduktua në 2 vjet heqje lirie.<sup>24</sup>

Ndërkohë, edhe ish-nënkryetari i bashkisë Kukës, Granit Gjana, i cili u emërua në pozicionin e Prefektit, është vendosur nën hetim nga SPAK me akuzën për shkelje të barazisë në tendera.<sup>25</sup> Z. Gjana është pezulluar nga detyra dhe vijon të jetë nën hetim nga organet ligj zbatuese. Kështu në një hark kohor prej pak muajsh, kupola politike drejtuese e ekzekutivit në Kukës u procedua nga SPAK. Drejtuesi i Prokurorisë së Kukësit Xhevahir Lita u arrestua nga SPAK si i dyshuar në lidhje me krimin e organizuar, e ndjekur me pezullim nga detyra nga KLP.<sup>26</sup>

Presioni publik dhe i faktorit ndërkombëtar, i kombinuar me institucione funksionale të sistemit të ri të drejtësisë duket se po jep efektet e para të çrrënjësjes së kulturës së pandëshkueshmërisë edhe në nivele të larta të qeverisjes, drejtësisë dhe administratës publike.

---

<sup>24</sup> Edmond Hoxhaj. “Safet Gjici dënohet për “shpërdorim detyre” për aferën seksuale në zyrën e tij”. 7 shkurt 2024. Repoter.al, <https://www.reporter.al/2024/02/07/safet-gjici-denohet-per-shperdorim-detyre-per-afere-seksuale-ne-zyren-e-tij/>

<sup>25</sup> “Prefekti i Kukësit në hetim për abuzim me tendera! GJKKO konfirmon pezullimin nga detyra të Granit Gjanës! Tregon pse u dorëhoq”, Report TV, 7 dhjetor 2023. <https://www.report-tv.al/lajm/nen-hetim-per-abuzim-me-tenderat-ishzvkrjetari-i-bashkise-kukes-granit-gjana-paraqitet-ne-spak-sot-seanca-per-masen-e-sigurise-ndaj-tij>


<sup>26</sup> “U arrestua nga SPAK, KLP pezullon nga detyra drejtuesin e Prokurorisë së Kukësit Xhevahir Lita”, Ballkan Web, 31 korrik 2023. <https://www.balkanweb.com/u-arrestua-nga-spak-klp-pezullon-nga-detyra-drejtuesin-e-prokurorise-se-kukesit-xhevahir-lita/#gsc.tab=0>

## V. DEKRIMINALIZIMI DHE SPAK NË QARKUN DIBËR (TETOR 2023 – JANAR 2024)

Qarku Dibër përfshin katër njësi vendore, bashkinë Dibër, Bulqizë, Mat dhe Klos. Në zgjedhjet lokale të 14 majit 2023 janë zgjedhur 4 kryetarë bashkie dhe 113 anëtarë për këshillin bashkiak. Në bashkinë Dibër rezultoi fitues Rahim Spahiu (PS), në Bulqizë Festime Mjeshtri (PS), në Mat Agron Malaj (PS) dhe në Klos Valbona Kola (PS).

Nga verifikimet e formularëve të dekriminalizimit dhe nga monitorimi i ISP, rezulton se në nivel qarku, një kryetar bashkie Agron Malaj, (PS, bashkia Mat) dhe pesë (5) anëtarë të këshillave bashkiakë janë me rekorde kriminale. Për 5 anëtarë të këshillave bashkiakë të këtij qarku mungojnë formularët e dekriminalizimit që duhej të ishin publikuar në faqen zyrtare të KQZ.

Nga monitorimi i ISP rezulton se nga 31 anëtarë të zgjedhur në këshillin bashkiak të Dibrës, 2 individë (T.D dhe S.S) janë me rekorde kriminale. Të dy këta individë janë përfaqësues të Partisë Socialiste. Ndërsa në rang qarku, koalicioni Bashkë Fitojmë ka 1 anëtar të zgjedhur në këshillin bashkiak të Bulqizës, i cili rezulton me të shkuar kriminale, Ardhmëria për Shqipërinë po ashtu 1 anëtar. Në periudhën shtator 2023 - janar 2024, 4 këshilltarë janë dorëhequr në qarkun e Dibrës. Në bashkinë Dibër 3 këshilltarë bashkiakë të PSD, K.A, B.L dhe F.T u dorëhoqën, ndërsa në bashkinë Klos, B.D (PS) ka dhënë dorëheqjen nga këshilli bashkiak. Edhe në këtë rast nuk bëhen të ditura arsyet e dorëheqjes.



*Tabela 3\_Nr. i këshilltarëve me rekorde kriminale qarku Dibër*

Në datë 15 mars 2023, Lefter Alla kryetar i bashkisë Bulqizë (Partia Socialiste) dhe 7 zyrtarë të tjerë të bashkisë u arrestuan nga SPAK nën akuzën e shpërdorimit të tenderave, duke shkaktuar dëm të konsideruar në buxhetin e shtetit.<sup>27</sup> Zyrtarë të arrestuar së bashku me z. Alla janë: E.Lleshi, R.Kola, A.Gjoka, K.Zogu, E.Isaku, L.Daçi, D.Xholi, K.Ibrahimaj, të cilët akuzohen për “shkelje të barazisë në tendera” dhe “shpërdorim të detyrës”. Në dhjetor 2023, GJKKO dënoi me 2 vite burg ish-kryebashkiakun e Bulqizës, Lefter Alla dhe 8 persona të tjerë u gjetën fajtorë

<sup>27</sup> “Lefter Alla u arrestua, Gëzim Xhafa zgjidhet kryetari i ri i bashkisë Bulqizë, Top Channel”, 31 mars 2023. <https://top-channel.tv/video/top-channel-lefter-alla-u-arrestua-gezim-xhafa-zgjidhet-kryetari-i-ri-i-bashkise-bulqize/>

nga Gjykata e Posaçme, për akuzat e shpërdorimit të detyrës, shkelje të barazisë në tendera dhe falsifikimit.<sup>28</sup>

Tre zyrtarë të bashkisë Bulqizë, përfshirë kryetarin e njësisë administrative Ostren (L.M) u arrestuan nën akuzën për shpërdorim detyre dhe falsifikim të dokumenteve të gjendjes civile.<sup>29</sup>

Edhe në qarkun e Dibrës, dhe posaçërisht në bashkinë e Dibrës vihet re një rënie e ndjeshme e numrit të individëve të zgjedhur me rekorde kriminale. Partitë politike janë vendosur përballë presionit të opinionit publik, partnerëve ndërkombëtarë dhe institucioneve të drejtësisë për të nominuar persona të pastër dhe me integritet në funksionet publike. Megjithatë, ndikimi informal i individëve me të shkuar kriminale mbetet problem. Forcimi i institucioneve të drejtësisë dhe lufta ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar është një garanci shtesë se edhe ndikimet e padëshiruara apo kontaktet e papërshtatshme me individë me rekorde korruptive dhe kriminale do të adresohen.

## PËRFUNDIME

Shqipëria ka bërë progres në implementimin e ligjit të dekriminalizimit në mënyrë më gjithëpërfshirëse. Të detyruar nga presioni në rritje i opinionit publik dhe faktorit ndërkombëtar, partitë politike kanë miratuar kode etike dhe janë distancuar relativisht nga praktika e kandidimit apo emërimit të individëve me të shkuar kriminale dhe korruptive në funksionet publike. Zgjedhjet e vendore të 14 majit 2023 prodhuan më pak funksionarë me rekorde kriminale dhe korruptive. Vetëm 5 kandidatë për kryetar bashkie u identifikuan me probleme me të shkuarën e tyre legale, ndërsa nga rreth 1600 këshilltarë të zgjedhur disa dhjetëra rezultuan të kenë rekorde kriminale. Ky është një hap pozitiv në drejtim të ndarjes së politikës dhe administratës publike nga bota e krimit dhe për forcimin e shtetit të së drejtës dhe institucioneve demokratike në vend.

Megjithatë, format informale të ndikimit të individëve me të shkuar korruptive dhe kriminale mbeten shqetësim.<sup>30</sup> Në disa bashki (Durrës p.sh) individë me probleme me ligjin zhvilluan fushatë hapur për kandidatin e Partisë Socialiste.<sup>31</sup> Në formularët e dekriminalizimit të kandidatëve për kryetar bashkie vijohet të shfaqen raste të personave me rekorde kriminale. Partitë jo parlamentare duket se janë bërë strehë e lehtë për këta individë, të cilët kërkojnë një funksion publik për reputacion dhe mbrojtje nga drejtësia. Ndërsa partitë e mëdha

<sup>28</sup> “Dy vjet burg për Lefter Allën, ish-kryetari i bashkisë Bulqizë dënohet për tre akuza”, ABC Neës, 28 dhjetor 2023. <https://abcnews.al/dy-vjet-burg-per-lefter-allen-ish-kryetari-i-bashkise-bulqize-denohet-per-tre-akuza/>

<sup>29</sup> “Dhanë vërtetime false deri në 100 mijë lekë që qytetarët të përfitonin pasaporta bullgare, pranga 3 punonjësve të njësisë Ostren dhe bashkisë Bulqizë”, Shqiptarja.com, 21 dhjetor 2023. <https://shqiptarja.com/lajm/pajisen-disa-qytetare-me-dokumente-false-qe-te-perfitonin-pasaporta-bullgare-arrestohen-3-punonjes-te-bashkise-bulqize-emrat>

<sup>30</sup> ISP. (2023). Dekriminalizimi dhe integriteti: Raport me gjetje dhe rekomandime 2021-2023. <https://dekriminalizimi.isp.com.al/dekriminalizimi-dhe-integriteti-raport-me-gjetje-dhe-rekomandime-2021-2023/>

<sup>31</sup> “I shpallur “non grata” nga SHBA, Vangjush Dako bën fushatë për Emirjana Sakon”, Dosja.al, 6 shkurt 2022. <https://dosja.al/ft-i-shpallur-non-grata-nga-shba-vangjush-dako-ben-fushate-per-emirjana-sakon>

parlamentare janë nën syrin e medias dhe opinionit publik, kanë miratuar akte rregullatorë për verifikimin paraprak të personave me të shkuar kriminale apo korruptive, partitë jo parlamentare kanë treguar tendencë për të toleruar kandidatë me të shkuar kriminale për t'u bërë pjesë e garave zgjedhore.

Në qarqet Shkodër, Kukës dhe Dibër ligji i dekriminalizimit është jetësuar në tërësi duke rezultuar në të zgjedhur më me integritet dhe administratë publike më të pastër. Por, njësoj edhe këtu u evidentuan raste ku forcat politike (në Mat, Shkodër, Kukës) kandiduan individë me rekorde kriminale. Partitë parlamentare kanë treguar kujdes të paraqesin përpara zgjedhësve kandidatë me të shkuar të pastër. Ndërsa, vihet re se disa individë me rekorde kriminale kanë gjetur hapësirë tek partitë jashtëparlamentare duke dëshmuar kështu se parimet e dekriminalizimit përthihen në periferi të vendit dhe jetës politike.

Sa i përket luftës kundër korrupsionit, operacionalizimi i institucioneve të reja të drejtësisë ka shënuar progres në procedimin e rasteve në nivelet më të larta të shtetit deri tek pozita e ish-kryeministrit. Ish-funksionarë dhe funksionarë të lartë si ish-zëvendës kryeministri, ish-ministra dhe deputetë dhe ish-kryetarë bashkie u proceduan nga SPAK duke dhënë sinjale pozitive në luftën kundër kulturës së pandëshkueshmërisë në nivele të larta.

Edhe në Shkodër dhe Kukës, SPAK ka vepruar duke vënë para drejtësisë një kryetar bashkie, një nën-kryetar bashkie, dy prokurorë, një gjyqtar dhe një oficer policie. Ndërkohë, funksionarë të tjerë në nivele të mesme dhe të ulëta të administratës janë proceduar nga drejtësia gjithashtu për vepra penale, shpërdorim detyre apo korrupsion. Kjo dëshmon se drejtësia e re po funksionon, por mbështetja me burime dhe kapacitete njerëzore duhet të vijojë në mënyrë që lufta kundër korrupsionit të jetë e qëndrueshme dhe efektive.

## REFERENCAT

- “Amnistia penale: Shqetësimi mbi përfitimin e politikanëve dhe zyrtarëve objekt të SPAK”, ISP, 26 shkurt 2024. <https://dekriminalizimi.isp.com.al/amnistia-penale-shqetesimi-mbi-perfitimin-e-politikaneve-dhe-zyrtareve-objekt-te-spak/>
- “Dy vjet burg për Lefter Allën, ish-kryetari i bashkisë Bulqizë dënohet për tre akuza”, ABC News, 28 dhjetor 2023. <https://abcneës.al/dy-vjet-burg-per-lefter-allen-ish-kryetari-i-bashkise-bulqize-denohet-per-tre-akuza/>
- “Fshehu dënimin nga drejtësia greke, SPAK nis hetimet për kryebashkiakun e Kuçovës, Kreshnik Hajdari”, Ballkan Web, 26 qershor 2023. <https://www.balkanweb.com/fshehu-denimin-nga-drejtesia-greke-spak-nis-hetimet-per-kryebashkiakun-e-kucoves-kreshnik-hajdari/#gsc.tab=0>
- “Hetimi për inceneratorin e Tiranës, SPAK jep njoftimin zyrtar: 7 shkeljet dhe pse akuzohen”, Shqiptarja.com, 9 dhjetor 2023. <https://shqiptarja.com/lajm/hetimi-per-inceneratorin-e-tiranes-spak-jep-njoftimin-zyrtar-6-shkeljet-dhe-pse-akuzohen>
- “I shpallur “non grata” nga SHBA, Vangjush Dako bën fushatë për Emirjana Sakon”, Dosnja.al, 6 shkurt 2022. <https://dosja.al/ft-i-shpallur-non-grata-nga-shba-vangjush-dako-ben-fushate-per-emirjana-sakon>
- “Lefter Alla u arrestua, Gëzim Xhafa zgjidhet kryetari i ri i bashkisë Bulqizë, Top Channel”, 31 mars 2023. <https://top-channel.tv/video/top-channel-lefter-alla-u-arrestua-gezim-xhafa-zgjidhet-kryetari-i-ri-i-bashkise-bulqize/>
- “Përplasje mes PS dhe PSD? Ikën kryetarja e qarkut Shkodër, zëvendësohet nga një socialist. Çfarë thotë vetë”. Java News, 29 janar 2024. <https://javanews.al/perplasje-mes-ps-dhe-psd-iken-kryetarja-e-qarkut-shkoder-zevendesohet-nga-nje-socialist-cfare-thote-vete/>
- “Prefekti i Kukësit në hetim për abuzim me tendera! GJKKO konfirmon pezullimin nga detyra të Granit Gjanës! Tregon pse u dorëhoq”, Report TV, 7 dhjetor 2023. <https://www.report-tv.al/lajm/nen-hetim-per-abuzim-me-tenderat-ishzvkrzetari-i-bashkise-kukes-granit-gjana-paraqitet-ne-spak-sot-seanca-per-masen-e-sigurise-ndaj-tij>
- “SPAK tre akuza ndaj Arben Ahmetajt, sa vite burg rrezikon ish-ministri”, ABC News, 10 korrik 2023. <https://abcnews.al/spak-tre-akuza-ndaj-arben-ahmetajt-sa-vite-burg-rrezikon-ish-ministri/>
- “U arrestua nga SPAK, KLP pezullon nga detyra drejtuesin e Prokurorisë së Kukësit Xhevahir Lita”, Ballkan Web, 31 korrik 2023. <https://www.balkanweb.com/u-arrestua-nga-spak-klp-pezullon-nga-detyra-drejtuesin-e-prokurorise-se-kukesit-xhevahir-lita/#gsc.tab=0>
- “Zgjedhjet e 14 majit, KQZ çon për verifikim të thelluar 10 kandidatë për kryetar bashkie dhe 28 për anëtarë këshilli”, Top Channel, 9 maj 2023. <https://top-channel.tv/2023/05/09/zgjedhjet-e-14-majit-kqz-con-per-verifikim-te-thelluar-10-kandidate-per-kryetar-bashkie-dhe-28-per-anetare-keshilli/>

- Albanian prosecutors charge former Prime Minister Sali Berisha in corruption probe, Reuter, 22 October 2023. <https://www.reuters.com/world/europe/albanian-prosecutors-charge-former-pm-berisha-corruption-probe-2023-10-22/>
- Dhanë vërtetime false deri në 100 mijë lekë që qytetarët të përfitonin pasaporta bullgare, pranga 3 punonjësve të njësisë Ostren dhe bashkisë Bulqizë”, Shqiptarja.com, 21 dhjetor 2023. <https://shqiptarja.com/lajm/pajisen-disa-qytetare-me-dokumente-false-qe-te-perfitonin-pasaporta-bullgare-arrestohen-3-punonjes-te-bashkise-bulqize-emrat>
- EU Commission progress report on Albania, 2023. Final: Brussels. [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda\\_23\\_5612](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda_23_5612)
- Hoxhaj, Edmond. “Pas publikimit të videos seksuale, Safet Gjici arrestohet për korrupsion”. Reporter.al 25 qershor 2023. <https://www.reporter.al/2023/06/24/pas-publikimit-te-videos-seksuale-safet-gjici-arrestohet-per-korrupsion/>
- Hoxhaj, Edmond. “Safet Gjici dënohet për “shpërdorim detyre” për aferën seksuale në zyrën e tij”. 7 shkurt 2024. Reporter.al, <https://www.reporter.al/2024/02/07/safet-gjici-denohet-per-shperdorim-detyre-per-aferen-seksuale-ne-zyren-e-tij/>
- Hoxhaj, Edmond. “SPAK kërkon 2.6 vjet burg për Fredi Belerin”. Reporter.al, 13 shkurt 2023. <https://www.reporter.al/2024/02/13/spak-kerkon-2-6-vjet-burg-per-fredi-belerin/>
- ISP. (2021). Dekriminalizimi dhe integriteti i zyrtarëve të zgjedhur: zgjedhjet 2021. <https://dekriminalizimi.isp.com.al/raport-i-isp-dekriminalizimi-dhe-integriteti-i-zyrtareve-te-zgjedhur-zgjedhjet-2021/>
- ISP. (2022). Institucionet, mbi 90% e tyre nuk i publikojnë formularët e dekriminalizimit. <https://dekriminalizimi.isp.com.al/institucionet-mbi-90-e-tyre-nuk-i-publikojne-formularet-e-dekriminalizimit/>
- ISP. (2022). Integriteti i zyrtarëve të lartë dhe standardet e dekriminalizimit. <https://dekriminalizimi.isp.com.al/integriteti-i-zyrtareve-te-larte-dhe-standardet-e-dekriminalizimit-2022/>
- ISP. (2023). Dekriminalizimi dhe integriteti: Raport me gjetje dhe rekomandime 2021-2023. <https://dekriminalizimi.isp.com.al/dekriminalizimi-dhe-integriteti-raport-me-gjetje-dhe-rekomandime-2021-2023/>
- ISP. (2023). Dekriminalizimi dhe integriteti: Raport me gjetje dhe rekomandime 2021-2023. <https://dekriminalizimi.isp.com.al/dekriminalizimi-dhe-integriteti-raport-me-gjetje-dhe-rekomandime-2021-2023/>
- ISP. (2023). Dekriminalizimi dhe integriteti: Raport me gjetje dhe rekomandime 2021-2023. <https://dekriminalizimi.isp.com.al/dekriminalizimi-dhe-integriteti-raport-me-gjetje-dhe-rekomandime-2021-2023/>
- ISP. (2023). Mbi standardet e integritetit dhe dekriminalizimit në 12 qarqe (II) <https://dekriminalizimi.isp.com.al/isp-mbi-standardet-e-integritetit-dhe-dekriminalizimit-ne-12-qarqe-ii/>
- Karaj, Vladimir. “Hetim i ri në SPAK, kontrollohet shtëpia e ish-ministrit Ilir Beqaj”, Reporter.al, 29 dhjetor 2023. <https://www.reporter.al/2023/12/29/hetim-i-ri-ne-spak-kontrollohet-shtepia-e-ish-ministrit-ilir-beqaj/>

**INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE**

Web: [www.isp.com.al](http://www.isp.com.al)

E-mail: [contactaips@isp.com.al](mailto:contactaips@isp.com.al)

Facebook: **Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies**

Adresa: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap. 16, Tiranë